



VOTO
10

PËR NJË SHQIPËRI

KU IA DEL ME PUNË

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

AGRON SHEHAJ

PARTIA
MUNDËSIA

11 MAJ ZGJEDHJET
PËR KUVEND
2025



VIZIONI I PARTISË MUNDËSIA:

PËR NJË SHQIPËRI KU IA DEL ME PUNË

Shqipëria ndodhet në një moment kritik të historisë së saj. Pas 34 vitesh, Shqipëria vazhdon të jetë një nga vendet më të varfëra në Europë, nga ku shqiptarët vazhdojnë të largohen. Prandaj nevojitet një ndryshim rrënjësor që ti japë mundësinë shqiptarëve që t'ia dalin në vendin e tyre me punë të nderhme.

Ne besojmë në një shtet të vogël, që i lë qytetarët të lirë të ndërtojnë të ardhmen e tyre pa ndërhyrje të panevojshme. Ne duam një Shqipëri ku qytetarët nuk e ndiejnë shtetin si barrë, por si garantues të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Një shtet që nuk rëndon mbi qytetarin është një shtet që i jep mundësi çdo individi të lulëzojë.

Ne besojmë se mirëqenia dhe zhvillimi ekonomik vijnë nga liria dhe përgjegjësia individuale. Një shqiptar i lumtur është një shqiptar i pasur dhe i lirë të realizojë potencialin e tij. Prandaj,

Partia Mundësia angazhohet për uljen e kostos së administratës dhe ulje të taksave sepse paratë e fituara me punë të nderhme duhet të mbeten në duart e qytetarëve, jo të shtetit.

Ne besojmë se këto 34 vite korrupsioni ka qenë arsyeja kryesore që ka penguar shqiptarët që të ndërtojnë një jetë më të mirë në Shqipëri. Lufta kundër korrupsionit është jetike për të krijuar kushtet për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në Shqipëri. Drejtësia është shtylla kryesore e një shoqërie të lirë dhe të drejtë. Ne angazhohemi për një drejtësi të pavarur dhe të fortë, ku ligji zbatohet për të gjithë në mënyrë të barabartë. Vetëm një sistem drejtësie që nuk ndikohet nga politika mund të garantojë një Shqipëri të drejtë, të sigurt dhe të begatë.

Ne jemi partia e mundësive, e njerëzve që duan të ndërtojnë jetën e tyre pa pengesa nga shteti. Prioriteti ynë është që Shqipërinë ta anëtarësojmë me të drejta të plota në Bashkimin Europian.



ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SIPËRMARRJA

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

**PËR SHQIPTARË QË PASUROHEN NGA PUNA E TYRE,
JO NGA LIDHJET POLITIKE.**

● **PËRGJYSMIMI I TAKSAVE ME VENDOSJEN E TAKSËS
SË SHESHTË 8%**

Sistemi aktual fiskal në Shqipëri është i komplikuar, me taksa të larta që rëndojnë mbi bizneset dhe qytetarët. Duke vendosur një taksë të sheshtë prej 8%, jo vetëm thjeshtëzojmë sistemin fiskal por edhe lehtësojmë ndjeshëm barrën tatimore. Ulja e taksave stimulon investimet, nxit rritjen ekonomike dhe krijon vende pune, duke bërë që shqiptarët të pasurohen nga puna e tyre e ndershme, jo nga lidhjet politike.

Praktika ndërkombëtare ka treguar se taksa e ulët dhe e thjeshtë nxit bindjen ndaj ligjit fiskal dhe zvogëlon informalitetin ekonomik, duke sjellë më shumë të ardhura në buxhet përmes zgjerimit të bazës tatimore.

● **SHKURTIMI I KOSTOVE TË ADMINISTRATËS DUKE
KURSYER 1 MILIARD EURO NË VIT**

Administrata shqiptare sot është e fryrë, joefikase dhe shpeshherë abuzive me fondet publike. Nëpërmjet reduktimit të burokracisë, eliminimit të punësimeve fiktive dhe kontrollit të rreptë mbi shpenzimet, mund të kursehen të paktën 1 miliard euro në vit.

Ky kursim do të bëjë të mundur uljen e taksave dhe rritjen e investimeve në sektorët jetikë si arsimi dhe shëndetësia, duke përmirësuar jetën e përditshme të qytetarëve. Për më tepër, një administratë më e vogël dhe më efikase do të jetë më pak e korruptuar dhe më transparente, duke rritur besimin e qytetarëve tek institucionet.

Gjysma e shumës së kursyer, pra 500 milionë euro, do të shkojnë për shëndetësinë, arsimin, pensionet dhe kontributin për fëmijët në familje në nevojë. Gjysma tjetër do të ndihmojë në ekuilibrimin e buxhetit pas vendosjes së taksës së sheshtë.

● **HEQJA E KONTROLLEVE SHTETËRORE MBI BIZNESET
E REJA PËR 3 VITET E PARA**

Bizneset e reja janë thelbësore për një ekonomi të shëndoshë. Aktualisht, sipërmarrësit përballen me kontrolle të shpeshta dhe shpesh të padrejta, që pengojnë zhvillimin e tyre dhe krijojnë pasiguri.

Heqja e këtyre kontrolleve për tre vitet e para do t'u japë sipërmarrësve kohën e nevojshme për të forcuar biznesin e tyre, duke inkurajuar sipërmarrjen, inovacionin dhe punësimin. Një politikë e tillë është përdorur me sukses në disa vende të zhvilluara, duke rezultuar në rritje të shpejtë ekonomike dhe rënie të papunësisë.

● **LUFTA KUNDËR MONOPOLEVE DHE AUTOMATIZIMI I PROCESEVE DOGANORE ME INTELIGJENCË ARTIFICIALE**

Monopolet dhe oligopolet janë pengesë serioze për ekonominë shqiptare. Ato krijojnë padrejtësi në treg dhe rrisin çmimet artificialisht, duke rënduar drejtpërdrejt mbi qytetarët.

Automatizimi i proceseve doganore me Inteligjencë Artificiale do të reduktojë korrupsionin, do të rrisë transparencën dhe do të ulë kostot operacionale, duke bërë që çmimet të bien në nivele më konkurruese dhe duke rritur fuqinë blerëse të qytetarëve. Për më tepër, automatizimi do të përmirësojë efikasitetin në dogana, duke nxitur tregtinë ndërkombëtare dhe duke bërë vendin më tërheqës për investime.

● **ANULIMI I KONCESIONEVE DHE PPP-VE ABUZIVE**

Koncesionet dhe Partneritetet Publike-Private (PPP) janë bërë shpesh instrumente korrupsioni që rëndojnë mbi buxhetin e shtetit.

Anulimi i kontratave abuzive, të cilat janë nën hetim nga SPAK, dhe ndjekja ligjore ndaj përgjegjësve dhe përfituesve do të rimarrë fondet publike të humbura dhe do të forcojë sundimin e ligjit.

Kjo do të kthejë besimin e qytetarëve tek institucionet dhe do të ndalojë abuzimin me paratë publike. Përveç kësaj, një auditim i plotë dhe transparenca në kontratat e ardhshme do të parandalojnë përsëritjen e këtyre abuzimeve.

● **TËRHEQJA E INVESTIMEVE TË HUAJA**

Shqipëria ka nevojë urgjente për investime të huaja për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të krijuar vende pune cilësore. Për këtë është jetike krijimi i një ambienti të qëndrueshëm ekonomik dhe ligjor, i cili garanton siguri për investitorët dhe stimulon ardhjen e kapitalit të huaj, duke mundësuar transferimin e teknologjive moderne dhe zgjerimin e tregut.

Investimet e huaja gjithashtu sjellin njohuri dhe eksperiencë menaxheriale, duke kontribuar në modernizimin e ekonomisë shqiptare.

● **NGRIRJA E POLITIKAVE FISKALE PËR 10 VITE**

Investitorët kërkojnë stabilitet dhe parashikueshmëri për të bërë plane afatgjata. Duke ngrirë politikat fiskale për një dekadë, sigurojmë një klimë të qëndrueshme për investimet e brendshme dhe të huaja, duke eliminuar pasiguritë që sot pengojnë sipërmarrjen dhe zhvillimin ekonomik.

Stabiliteti fiskal është element kyç për tërheqjen e kapitalit serioz dhe për forcimin e besimit të bizneseve.

● **ADOPTIMI I EUROS SI MONEDHË KOMBËTARE**

Monedha kombëtare aktuale është e ekspozuar ndaj luhatjeve të vazhdueshme, duke sjellë pasiguri ekonomike. Kalimi në Euro sjell stabilitet monetar, norma më të ulëta interesi për kreditë dhe reduktim të kostove të borxhit publik, duke lehtësuar barrën mbi ekonominë shqiptare.

Euro gjithashtu ndihmon bizneset eksportuese të mbrohen nga rreziku i luhatjeve të kursit të këmbimit dhe rrit konkurrueshmërinë në tregun evropian, duke e bërë Shqipërinë një destinacion më tërheqës për investitorët ndërkombëtarë.

● **AUTOMATIZIMI I LEJEVE TË NDËRTIMIT ME INTELIGJENCË ARTIFICIALE**

Proçesi aktual i dhënies së lejeve të ndërtimit është një nga burimet kryesore të korrupsionit në vend. Implementimi i Inteligjencës Artificiale për automatizimin e këtij procesi do të eliminojë subjektivitetin dhe korrupsionin, duke e bërë procesin transparent, të shpejtë dhe të drejtë për të gjithë aplikuesit.

Modelet e suksesshme si në Dubai dhe Singapor tregojnë se kjo qasje rrit transparencën dhe besimin publik, si dhe përshpejton ndjeshëm zhvillimin ekonomik në sektorin e ndërtimit.



DREJTËSIA DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

PËR NJË DREJTËSI TË FORTË, TË PAVARUR DHE TË PAPREKSHME NGA NDIKIMET POLITIKE, MASAT E PROPOZUARA SYNOJNË TË KRIJOJNË NJË MJEDIS KU LIGJI ZBATOHET NË MËNYRË TË BARABARTË PËR TË GJITHË, PA FAVORIZIME OSE NDIKIME TË JASHTME

● **MBËSHTETJE E PLOTË PËR SPAK-UN ME FINANCIM TË MJAFTUESHËM DHE KOMPETENCA TË ZGJERUARA**

Sigurimi i një financimi adekuat për SPAK-un do të mundësojë punën e tij të specializuar në hetimin e rrjeteve korruptive, duke përfshirë raste komplekse që shpesh kanë lidhje ndërmjet sektorëve politikë dhe ekonomikë.

Me burimet e duhura, SPAK-u do të ketë akses në teknologji të avancuar dhe ekspertizë të specializuar, duke bërë mund të hetojë në mënyrë të pavarur, pa ndikim të jashtëm, gjë që përforcon besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

● **NDËSHKIM I ASHPËR NDAJ KORRUPSIONIT POLITIK DHE EKONOMIK PËRMES LIGJEVE QË MUNDËSOJNË RIKUPERIMIN E PARAVE TË VJEDHURA**

Krijimi i një kuadri ligjor të fortë që përfshin masa ndëshkimore të rrepta dhe mekanizma për rikuperimin e fondeve të devijuara është thelbësor. Ky lloj legjislacioni dërgon mesazhin se çdo akt i korruptimit, pavarësisht nga niveli në hierarkinë shtetërore, do të hasë në ndëshkime të rrepta dhe do të kontribuojë në rikthimin e pasurisë publike te shteti dhe qytetarët. Kjo do të përmirësojë ndjenjën e drejtësisë dhe barazisë në shoqëri.

● **NDALIMI I PJESËMARRJES SË KOMPANIVE OFFSHORE ME PRONARË TË FSHEHUR NË TENDERA PUBLIKË**

Përdorimi i kompanive offshore për të fshehur identitetin e pronarëve krijon një mjedis të fshehjes së vërtetë të pasurisë dhe gjymton transparencën në prokurimet publike.

Duke ndaluar pjesëmarrjen e këtyre kompanive, do të jetë e mundur të zbulohet identiteti i plotë i përfituesve të tenderave dhe të parandalohen struktura që favorizojnë shpërdorimin e fondeve publike për interes personal, duke ndihmuar kështu në eliminimin e korupsionit në rrënjë.

● **FORCIMI I HETIMIT FINANCIAR PËR ÇDO ZYRTAR TË LARTË**

Rritja e frekuencës dhe thellësisë së hetimeve financiare për zyrtarët në pozicione të larta do të zbulojë çdo përpjekje për fshehjen e pasurisë personale përmes mekanizmave të ndërlikuar. Ky proces do të krijojë një pengesë të fortë ndaj abuzimeve dhe do të nxisë një kulturë llogaridhënieje mes autoriteteve publike, duke garantuar që askush të mos përfitojë në mënyrë të paligjshme nga pozita që mban.

● **RRITJA E TRANSPARENCËS NË TENDERAT PUBLIKË**

Proceset e hapura dhe të monitoruara mirë në tenderat publikë jo vetëm që eliminojnë mundësitë për ndërhyrje jo të ligjshme, por edhe garantojnë se të gjithë ofertuesit kanë mundësi të barabarta për të konkurruar.

Transparenca e plotë e të dhënave të tenderave publike dhe publikimi i rezultateve të detajuara të vendimmarrjes do të lehtësojë kontrollin nga organizata të pavarura dhe nga vetë qytetarët, duke krijuar një ambient të ndershëm dhe të besueshëm për shpenzimet publike.

● **PUNËSIMI I DREJTPËRDREJTË I PROFESIONISTËVE NGA VENDET PARTNERE TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Angazhimi i profesionistëve me përvojë ndërkombëtare, si juristë, gjykatës dhe prokurorë, do të sjellë metodologji dhe standarde të avancuara në zbatimin e ligjit.

Ky bashkëpunim ndërkombëtar jo vetëm që forcon aftësitë e brendshme të institucioneve tona, por gjithashtu përmirëson imazhin ndërkombëtar të vendit në fushën e drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit.

Përvoja perëndimore mund të përshtatet dhe të lokalizohet në mënyrë që të adresohet konteksti specifik i sfidave që përballen vendi.

● **E DREJTA PËR TË KËRKUAR NJË PRONË TË VJEDHUR NUK SHUHET KURRË**

Përpjekjet për rikthimin e pronave të humbura nga regjimi komunist, janë një formë drejtësie historike dhe një simbol i përpjekjes për të ndrequr padrejtësitë e së kaluarës.

Zbatimi i politikave për kthimin fizik të pronave, kur është i mundur, së bashku me kompensime të drejta financiare për pjesën që nuk mund të rikthehet, do të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, ku viktimat e padrejtësive të së kaluarës do të ndihen të mbështetura dhe të vlerësuara.



SHTET EFIKAS DHE ADMINISTRATË TRANSPARENTE

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

PËR NJË SHTET QË SYNON MODERNIZIMIN, INOVACIONIN DHE NJË SHËRBIM PUBLIK CILËSOR. REFORMAT E PROPOZUARA DO TË LEHTËSOJNË PROCESET ADMINISTRATIVE DHE DO TË GARANTOJNË NJË FUNKSIONIM TË SHPEJTË DHE TË NDERSHËM

RISHIKIMI I PROCESVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE ME PËRDORIM TË TEKNOLOGJISË

Modernizimi i sistemeve administrative me ndihmën e teknologjisë së informacionit mund të revolucionarizojë mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike.

Automatizimi i proceseve administrative jo vetëm që zvogëlon kohën e nevojshme për përpunimin e kërkesave, por edhe minimizon gabimet njerëzore dhe redukton mundësinë e manipulimit.

Kjo do të sjellë një administratë më efikase dhe një shërbim publik më të shpejtë dhe të besueshëm për qytetarët dhe bizneset.

MERITOKRACI DHE TRANSPARENCË NË PUNËSIMIN E ADMINISTRATËS

Vendosja e një sistemi rekrutimi të bazuar në meritë dhe kompetencë siguron që vetëm individët më të aftë dhe të përkushtuar të përfshihen në administratë.

Kjo qasje eliminon ndikimet politike gjatë procesit të punësimit dhe kontribuon në ngritjen e një kulture profesionale ku çdo zyrtar vepron sipas aftësive dhe performancës së tij.

Transparenca gjatë gjithë procesit rekrutues është çelësi për të krijuar një administratë që qytetarët e konsiderojnë si të ndershme dhe efektive.

REFORMIMI I PROCESVE VENDIMMARRËSE TË ADMINISTRATËS PËR ELIMINIMIN E DISKRECIONALITETIT

Standardizimi i procedurave dhe vendimmarrjes në administratë siguron që çdo vendim merret në mënyrë objektive dhe të bazuar në rregulla të paracaktuara. Eliminimi i hapësirave për diskrecionalitet në vendimmarrje do të zvogëlojë abuzimet dhe do të krijojë një ambient ku ligji zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme.

Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e një administrate publike që punon për interesin e përgjithshëm dhe jo për interesat personale ose të një grupi të vogël njerëzish.

DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR SHMANGIEN E BUROKRACISË

Shfrytëzimi i platformave dixhitale për ofrimin e shërbimeve publike sjell shumë përfitime, duke përfshirë uljen e vonesave, zvogëlimin e kontakteve fizike dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në shërbimet shtetërore.

Një sistem dixhital i mirëstrukturuar, ku çdo hap i procesit regjistrohet dhe monitorohet, garanton transparencë dhe efikasitet në marrjen e shërbimeve.

Kjo gjithashtu do të ulë mundësinë për ndërhyrje të paligjshme gjatë proceseve të punës në administratë dhe kontribuon në një mjedis me korrupsion të reduktuar.

REDUKTIMI I AFATEVE TË PROCESVEVE ADMINISTRATIVE PËR QYTETARËT DHE BIZNESET

Procedurat administrative të shpejta dhe të qarta janë çelësi për një mjedis ekonomik të favorshëm. Kur qytetarët dhe bizneset përfitojnë shërbime pa vonesa të panevojshme, rritet efikasiteti i ekonomisë dhe stimulohet inovacioni.

Proceset e reduktuara jo vetëm që do të sjellin përfitime të drejtpërdrejta në formën e kursimit të kohës dhe burimeve, por edhe do të rrisin besimin në institucionet publike, duke krijuar një klimë më të favorshme për investime të reja dhe për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.



ARSIMI, KULTURA DHE INOVACIONI

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

NJË SISTEM ARSIMOR I FORTË, I PAVARUR DHE I ORIENTUAR DREJT CILËSISË ËSHTË THEMELI I NJË SHOQËRIE TË ZHVILLUAR, DUKE NXITUR MENDIMIN KRITIK, KREATIVITETIN DHE AFTËSITË INOVATIVE TË TË RINJVE. KËTO MASA SYNOJNË TË SIGUROJNË QË ARSIMI TË JETË LARG NDIKIMEVE POLITIKE, TË FOKUSOHET NË ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE NXËNËSVE, DHE TË PËRGATISË BREZIN E RI PËR SFIDAT E NJË TREGU GLOBAL NË NDRYSHIM TË SHPEJTË DHE TË VAZHDUESHËM.

● **RINGRITJA E FIGURËS SË MËSUESIT NËPËRMJET DEPOLITIZIMIT DHE MBROJTJES ME LIGJ TË AUTORITETIT TË TIJ**

Mësuesi është personi që formon të ardhmen e shoqërisë dhe roli i tij nuk duhet të përshkruhet nga orientimet politike. Nëpërmjet depolitizimit, mësuesi do të ketë mundësinë të fokusohet në përmirësimin e metodave të tij pedagogjike dhe në përcjelljen e njohurive pa paragjykime.

Mbrojtja ligjore e autoritetit të tij garanton që vendimet e marra në mjedisin shkollor të jenë të bazuara në kualitetin akademik dhe etikën profesionale, duke krijuar një klimë ku të gjithë nxënësit përfitojnë nga mësimi pa ndikime ekstreme që mund të dëmtojnë integritetin e arsimit.

● **ASNJË DREJTOR SHKOLLE ME ANËTARËSI POLITIKE OSE PJESËMARRJE NË FUSHATA, PËR TË GARANTUAR PAPREKSHMËRINË E STAFIT MËSIMOR NGA POLITIKA**

Drejtuesit e shkollave duhet të jenë shembuj profesionalë të përkushtimit ndaj arsimit dhe të aftësisë menaxheriale, pa u ndikuar nga polarizimi politik.

Duke ndaluar pjesëmarrjen e drejtorëve në aktivitetet politike, sistemi arsimor do të ruajë neutralitetin dhe transparencën, duke siguruar që vendimet menaxheriale të jenë të orientuara drejt përmirësimit të mjedisit mësimor dhe të cilësisë së arsimit.

Kjo do të rezultojë në një ambient ku mësuesit mund të jenë të liri në shprehje dhe të fokusohen në inovacion dhe zhvillim profesional pa frikë nga ndonjë ndikim apo hakmarrje politike.

● **RRITJE E BUXHETIT TË SHTETIT PËR ARSIMIN, DUKE RRYTUR RROGAT E MËSUESVE DHE KUSHTET NË SHKOLLA**

Investimi në arsim është investim në të ardhmen e vendit. Rritja e buxhetit për arsimin do të mundësojë modernizimin e infrastrukturës, pajisjen me teknologji të avancuara dhe krijimin e kushteve më të mira për punën në shkolla.

Rritja e rrogave të mësuesve është një masë që jo vetëm motivon personelin e arsimit, por gjithashtu tërheq talente të reja në këtë sektor, duke garantuar që arsimi të mbetet një profesion i dëshirueshëm dhe prestigjioz. Kjo qasje ndihmon në krijimin e një ambienti ku cilësia arsimore mund të përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të arrijnë standarde të pranueshme europiane.

● **PAVARËSIMI I PLOTË DE FAKTO DHE DE JURE I ARSIMIT TË LARTË NGA QEVERIA**

Universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë u duhen dhënë autonomi të plotë në vendosjen e programeve, kërkimeve shkencore dhe bashkëpunimit me sektorin privat dhe ndërkombëtar. Kjo do të lejojë institucionet të përshtatin strategjitë e tyre sipas nevojave të tregut dhe të zhvillojnë programe inovative që reflektojnë sfidat globale.

Një arsimi i lartë autonom do të inkurajojë krijimin e hulumtimeve shkencore të pavarura, do të rrisë konkurrencën ndërmjet institucioneve dhe do të forcojë integrimin e universiteteve në rrjetet ndërkombëtare akademike.

● **NJËJTËSIMI I PROGRAMEVE SHKOLLORE ME ATO TË CAMBRIDGE**

Përmirësimi i kurrikulave në bazë të shembujve ndërkombëtarë, si sistemi i Cambridge, do t'i japë nxënësve shqiptarë një arsimin me përmbajtje moderne, të strukturuar dhe të orientuar drejt zhvillimit të aftësive analitike, kritike dhe gjuhësore.

Ky harmonizim i programeve siguron që nxënësit të jenë të përgatitur për studime të avancuara jashtë vendit dhe për të përballuar sfidat e një tregu pune global, duke rritur kështu konkurrueshmërinë e tyre në nivel ndërkombëtar.

● **THEMELIMI I INSTITUCIONIT ARSIMOR PËR NXËNËS ME INTELIGJENCË MBI MESATARE (MODELI ATOM NË KOSOVË)**

Krijimi i institucioneve të dedikuara për të zhvilluar talentet e veçanta është një hap thelbësor për nxjerrjen e potencialit të plotë të të rinjve. Këto institucione do të implementojnë programe të avancuara, do të bashkëpunojnë me ekspertë ndërkombëtarë dhe do të ofrojnë një ambient sfidues që nxjerr në pah aftësitë unike të secilit student.

Përveç kësaj, kjo masë do të krijojë një rrjet të fortë të të rinjve të talentuar, duke i dhënë atyre mundësi të përfshihen në projekte kërkimore dhe inovative që do të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së njohurive.

● **REFORMA NË PROGRAMET SHKOLLORE PËR TË PËRGATITUR TË RINJTË PËR TREGUN E PUNËS**

Përgatitja e të rinjve për realitetin e tregut të punës kërkon një qasje të integruar, ku kurrikula përfshin elementë praktikë, zhvillim aftësish teknike dhe ndërdisiplinare. Integrimi i praktikave të punës, trajnimet për zhvillim personal dhe bashkëpunimi me sektorin privat do të sigurojnë që nxënësit të kenë njohuri të azhurnuara dhe të përshtatura për kërkesat e tregut.

Kjo qasje do të zvogëlojë hendekun midis arsimit teorik dhe praktikës, një problem i trashëguar i sistemit tonë arsimor, duke nxitur kështu një tranzicion më të lehtë dhe më efikas nga shkolla në karrierë.

● **BURSA STUDIMI PËR STUDENTËT E EKSELENCËS NË FUSHA TË TEKNOLOGJISË, SHKENCAVE DHE INXHINIERISË**

Ofimi i bursave për studentët që arrijnë rezultate të larta dhe demonstrojnë potencial të madh në fushat kritike nuk është vetëm një masë stimulimi, por edhe një investim në zhvillimin e ekspertizës që do të jetë motor për inovacion dhe zhvillim ekonomik.

Këto bursa do të inkurajojnë studentët të angazhohen në kërkime të avancuara, të marrin pjesë në projekte ndërkombëtare dhe të kontribuojnë në krijimin e teknologjive të reja që do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit.

● **POLITIKA PËR KUJTESË KOMBËTARE PËR KRIMET E KOMUNIZMIT**

Ruajtja e kujtesës historike dhe nderimi i viktimave të regjimit komunist janë hapa të domosdoshëm për të ndërtuar një shoqëri të vetëdijshme dhe të drejtë. Krijimi i një politike të qartë për kujtesën kombëtare do të ndihmojë në edukimin e brezave të rinj mbi rëndësinë e lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Kjo masë do të parandalojë përsëritjen e gabimeve të së kaluarës, duke forcuar identitetin kombëtar dhe duke krijuar një bazë morale për zhvillimin e ardhshëm shoqëror.



RINIA DHE EMIGRACIONI

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

POLITIKAT QË MBËSHTESIN TË RINJTË DHE KRIJOJNË MUNDËSI TË REJA PËR ZHVILLIM PROFESIONAL DHE PERSONAL JANË ÇELËSI PËR TË NDËRTUAR NJË SHOQËRI DINAMIKE DHE PËR TË PARANDALUAR LARGIMIN E TALENTEVE TË RËNDËSISHME. KËTO MASA SIGUROJNË QË TË RINJTË TË KENË AKSES NË PUNËSIM ME DINJITET, MUNDËSI TË ZHVILLIMIT DHE BURIME PËR TË NDËRTUAR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME NË VEND.

● **MBËSHTETJE PËR BIZNESET QË PUNËSOJNË TË RINJ, PËRMES LEHTËSIRAVE FISKALE, SUBVENCIONEVE DHE PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT**

Ofrimi i stimuljeve fiskalë dhe subvencioneve për bizneset që angazhojnë të rinjtë do të ndihmojë në krijimin e vendeve dinjitoze të punës dhe në uljen e papunësisë në mesin e të rinjve. Këto masa jo vetëm që rrisin aftësinë konkurruese të bizneseve lokale, por gjithashtu inkurajojnë krijimin e një ambienti ku inovacioni dhe kreativiteti mund të lulëzojnë.

Programet e trajnimit dhe mentorimit lejojnë që të rinjtë të përvetësojnë aftësi praktike, të ndërtojnë rrjete profesionale dhe të ndihen më të sigurt në përballimin e sfidave të tregut të punës.

● **SUBVENCIONE PËR PROFESIONET E LIRA DHE STARTUP-ET**

Duke ofruar një sistem të thjeshtë dhe transparent për mbështetje financiare, qeveria jonë do të krijojë një klimë të favorshme për zhvillimin e nismave inovative dhe të sipërmarrjeve të reja.

Subvencionet për startup-et dhe profesionistët e pavarur inkurajojnë krijimin e ideve të reja, investimet në teknologji dhe zhvillimin e zgjidhjeve që adresojnë nevojat lokale dhe globale. Kjo qasje ndihmon të rinjtë të mos ndihen të penguar nga pengesat administrative, por të përqendrohen në transformimin e ideve të tyre në projekte konkrete dhe të qëndrueshme në tregun lokal apo ndërkombëtar.

● **PRAKTIKA PUNE TË PAGUARA PËR STUDENTËT**

Integrimi i praktikave të paguara në arsimin e lartë krijon një urë midis teorisë akademike dhe realitetit të tregut të punës. Këto praktika lejojnë studentët të fitojnë përvojë profesionale që është shumë e kërkuar nga punëdhënësit, duke u bërë kështu më konkurrues dhe të përgatitur për sfidat profesionale.

Për më tepër, kjo iniciativë krijon një ambient ku studentët mund të shohin se njohuritë e tyre akademike mund të aplikohen në mënyrë konkrete, duke rritur motivimin dhe angazhimin në fushën e tyre studimore.

● **KREDITË E BUTA PËR BANESË DHE BIZNES TË VOGËL PËR TË RINJTË NËN 30 VJEÇ**

Një sistem krediti me kushte të favorshme për të rinjtë është një instrument i rëndësishëm për të mbështetur iniciativat e reja ekonomike dhe për të krijuar stabilitet ekonomik. Duke ofruar kredi me norma të ulëta interesi dhe periudha të gjatë amortizimi, të rinjtë do të kenë mundësinë të investojnë në projekte që përmirësojnë jetesën e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Kjo strategji do të ndihmojë në parandalimin e emigracionit të fortë të talenteve, duke u dhënë mundësi të rinjve për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme në Shqipëri.



SHËNDETËSIA DHE POLITIKAT SOCIALE

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

NJË SISTEM SHËNDETËSOR I MODERNIZUAR DHE NJË POLITIKË SOCIALE E ORIENTUAR DREJT QYTETARËVE KRIJOJNË NJË SHOQËRI MË TË DREJTË DHE TË SIGURT, KU SECILI QYTETAR GJEN MBËSHTETJE PËR NJË JETË TË DENJË DHE NJË KUJDES SHËNDETËSOR CILËSOR.

● **RRITJA E BUXHETIT PËR SHËNDETËSINË, DUKE GARANTUAR PAGA MË TË LARTA PËR MJEKËT DHE KUSHTE MË TË MIRA NË SPITALE**

Në mënyrë që shëndetësia publike të jetë efektive, investimi i konsiderueshëm në buxhet është thelbësor. Rritja e buxhetit do të mundësojë rritjen e pagave për mjekët, duke i dhënë atyre motivimin dhe vlerësimin që meritojnë, si dhe do të mundësojë përmirësimin e pajisjeve dhe infrastrukturës në spitale.

Kjo do të krijojë një ambient ku profesionistët e mjekësisë punojnë në kushte optimale, duke rezultuar në diagnostikime më të sakta, trajtime më të shpejta dhe ulje të kohës së pritjes për pacientët.

● **KRIJIMI I NDËRMARRJES KOMBËTARE SHËNDETËSORE (MODELI I RI MENAXHIMI)**

Krijimi i një institucioni unik dhe të vetëm shëndetësor, me autonomi ligjore dhe financiare, do të konsolidojë menaxhimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore publike. Ky model inovativ përfshin bashkimin e institucioneve ekzistuese dhe konsolidimin e financave në një strukturë qendrore, e cila do të zbatojë vetëqeverisje për spitale.

Rezultati do të jetë një administrim më i efektshëm, ku vendimet merren bazuar në nevojat reale të pacientëve, eliminimi i shtresave burokratike të panevojshme dhe shpërndarja e burimeve në mënyrë më transparente dhe të drejtë. Krijimi i një institucioni të tillë, të vetëm, të ngjashëm me OSHEE-në, do të eliminojë burokraci të panevojshme dhe një numër të madh drejtorish dhe drejtorësh të panevojshëm.

● **BASHKËPUNIME STRATEGJIKE ME SEKTORIN PRIVAT PËR TË PLOTËSUAR BOSHLLËQET NË SHËRBIMET PUBLIKE**

Për të adresuar mangësitë në shërbimet publike, bashkëpunimi me sektorin privat është një strategji kyçe. Kjo përfshin inkurajimin e partneriteteve që sjellin efektivitet në marrjen e shërbimeve shëndetësore dhe zgjidhje të reja, duke krijuar një treg ku konkurrenca e shëndetshme stimulohet.

Hapja e tregut për subjekte të reja shëndetësore dhe përfshirja e tyre në tenderat publikë do të rezultojë në oferta më konkurruese, çmime më të ulëta dhe një standard më të lartë të shërbimeve që në përfundim i përmbush nevojat reale të qytetarëve.

● **DIGJITALIZIMI I PLOTË I SISTEMIT SHËNDETËSOR**

Në epokën digjitale, përmirësimi i menaxhimit shëndetësor kërkon një integrim të plotë të teknologjisë. Implementimi i një sistemi digjital do të lehtësojë qasjen në të dhënat mjekësore, do të përshpejtojë proceset e regjistrimit dhe trajtimit të pacientëve, dhe do të mundësojë komunikim më të shpejtë ndërmjet mjekëve dhe institucioneve.

Ky transformim digjital do të sjellë një sistem më transparent, ku çdo hap i trajtimit është i dokumentuar dhe monitoruar, duke ulur gabimet dhe rritur cilësinë e kujdesit shëndetësor, pavarësisht nëse trajtohen në spitale publike apo private.

● **PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË VENDIMMARRJE DHE REGJISTRIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE MJEK-PACIENT**

Teknologjia e inteligjencës artificiale mund të revolucionarizojë mënyrën se si merren vendime në sektorin shëndetësor. Duke përdorur algoritme të avancuara për analizimin e të dhënave, mund të identifikohen trendet dhe modele që ndihmojnë në parashikimin e nevojave të pacientëve dhe në optimizimin e proceseve diagnostike dhe terapeutike.

Regjistrimi automatik i të dhënave do të zvogëlojë ngarkesën administrative dhe do të sjellë një rritje të ndjeshme në saktësinë dhe transparencën e sistemit, duke reduktuar gjithashtu mundësitë për korrupsion.

● **MBËSHTETJA PËR QYTETARËT QË DUAN SIGURIM SHËNDETËSOR PRIVAT ME BAZA VULLNETARE**

Një skemë kombëtare e lehtësimit fiskal për sigurimet shëndetësore private ofron një alternativë të vlefshme për qytetarët, duke i lejuar ata të zgjedhin kujdesin shëndetësor sipas nevojave dhe preferencave të tyre.

Duke ndarë koston e sigurimit midis individit, punëdhënësit dhe shtetit në mënyrë të barabartë, kjo masë inkurajon zhvillimin e një tregu të hapur dhe konkurrues, ku standardet e shërbimeve përmirësohen vazhdimisht dhe qytetarët përfitojnë nga një gamë më e gjerë opsionesh.

● **RRITJA E PENSIONEVE DHE KONTRIBUTET MINIMALE PËR PENSIONISTËT**

Për të garantuar një jetë të denjë për të moshuarit, politikat e përmirësimit të pensioneve janë thelbësore. Ne propozojmë rritjen graduale të pensioneve, me një rritje prej 10% në vit, e cila do të ndihmojë në përmirësimin e nivelit të jetesës së pensionistëve, duke i dhënë atyre një stabilitet ekonomik afatgjatë.

Për ata pensionistë me të ardhura shumë të ulëta dhe që jetojnë në Shqipëri, kontributet minimale jetike do të sigurojnë që të mos bien nën një prag të caktuar (300 euro në muaj), duke eliminuar varfërinë dhe duke siguruar që çdo pensionist të ketë mbështetjen e nevojshme për një jetë të denjë.

- **KONTRIBUTI PËR ÇDO FËMIJË DERI NË 14 VJEÇ PËR FAMILJET ME TË ARDHURA NËN MESATARE**

Për të forcuar mbështetjen sociale dhe për të garantuar që brezat e rinj të kenë mundësi shancesh të barabarta, një kontribut financiar për fëmijët në familje me të ardhura të ulëta është një masë strategjike.

Duke siguruar një kontribut prej 600 euro në vit për çdo fëmijë në kushte të vështira familjare, shteti do të ndihmojë në uljen e barrës ekonomike mbi familjet, duke ofruar më shumë mundësi për edukim, shëndetësi dhe mirëqenie të përgjithshme.

Kjo masë jo vetëm që mbështet familjet, por edhe investon në të ardhmen e shoqërisë përmes investimeve direkte në kapitalin njerëzor.

- **SIGURIMI I NDIHMËS SOCIALE PËR ATA QË JANË NË NEVOJË REALE**

Një politikë e mirëstrukturuar sociale duhet të identifikojë dhe mbështesë drejtpërdrejt ata qytetarë që janë në situata të vërteta vështirësie. Kjo do të arrihet përmes krijimit të mekanizmave të qartë të vlerësimit dhe verifikimit, që eliminon përfitimet për individë të regjistruar fiktivisht (kryesisht ata me mbështetje partiake).

Në këtë mënyrë, burimet publike do të shkojnë tek ata që kanë nevojë reale, duke garantuar një shpërndarje të drejtë dhe efektive të ndihmave sociale.



BUJQËSIA

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

BUJQËSIA ËSHTË NJË SHTYLLË KRYESORE E EKONOMISË KOMBËTARE, KU TRANSPARENCA NË SHPËRNDARJEN E FONDEVE NGA BASHKIMI EUROPIAN, INOVACIONI DHE MODERNIZIMI MUND TË SJELLIN NJË TRANSFORMIM TË THELLË NË PRODHIMIN, EKSPORTET DHE MIRËQENIEN E FERMERËVE. KËTO MASA SYNOJNË TË KRIJOJNË NJË MJEDIS KONKURRUES DHE TRANSPARENT, KU ÇDO INVESTIM DHE MBËSHTETJE FINANCIARE KONTRIBUON DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM DHE MODERNIZIMIT TË KËTIJ SEKTORI

● **TRANSPARENCA E NDIHMËS EUROPIANE PËR FERMERËT SHQIPTARË**

Sigurimi që çdo euro e ndihmës që vjen nga Bashkimi Europian (si programi IPARD) të shkojë direkt tek fermerët shqiptarë është një garanci për përdorimin e duhur të fondeve. Proceset e përzgjedhjes bazohen në kritere të qarta dhe të matshme, duke eliminuar ndikimet politike dhe klientelizmin.

Kjo qasje garanton se mbështetja financiare arrin tek ata që kanë nevojë reale për investime në prodhim, duke inkurajuar një zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm në sektorin bujqësor.

● **LEHTËSIMI I EKSPORTEVE PËR PRODHIMET BUIQËSORE SHQIPTARE**

Përmes nënshkrimit të marrëveshjeve tregtare ndërkombëtare dhe eliminimit të barrierave burokratike, fermerët shqiptarë do të kenë akses më të lehtë në tregun global.

Kjo qasje do të ndihmojë në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore shqiptare, duke siguruar çmime më të mira për eksportuesit dhe duke rritur të ardhurat e fermerëve.

Nëpërmjet kësaj strategjie, prodhimet shqiptare do të pozicionohen si cilësore dhe të besueshme në tregjet ndërkombëtare, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja pune në zonën rurale.

● **FINANCIM PRIVAT DHE LEHTËSIM KREDITIMI**

Krijimi i skemave të garancive për huadhënie nga sektori privat dhe bankar është një masë strategjike për të mundësuar investime të reja në teknologji moderne dhe në përmirësimin e proceseve prodhuese.

Duke ofruar kushte të favorshme kreditimi, fermerët dhe agro-bizneset do të kenë mundësinë të rinovojnë pajisjet, të zgjerojnë kapacitetet e prodhimit dhe të përballojnë sfidat e tregut global. Kjo do të sjellë një rritje të produktivitetit dhe do të nxisë një klimë inovative, ku investimet financiare bëhen motor për transformimin dhe modernizimin e sektorit.



SIGURIA DHE RENDI PUBLIK

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

NJË POLICI PROFESIONALE, E CILA VEPRON PA NDIKIME POLITIKE, ËSHTË THEMELI I NJË SHOQËRIE TË SIGURT DHE TË QETË. KËTO MASA SYNOJNË TË FORCOJNË BESIMIN E QYTETARËVE TE INSTITUCIONET E RENDIT, DUKE SIGURUAR NJË AMBIENT KU ÇDO INDIVID NDJEHET I MBROJTUR

● **LUFTË PERSISTENTE KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE TRAFIQEVE ILEGALE**

Për të dhënë një përgjigje efektive ndaj krimit të organizuar, duhet krijuar një rrjet bashkëpunimi ndërmjet forcave të rendit vendase dhe agjencive ndërkombëtare. Ky bashkëpunim do të mundësojë shkëmbimin e informacionit inteligjent dhe koordinimin e operacioneve të përbashkëta, duke përdorur teknologji të avancuara për monitorim dhe analizë.

Përveç kësaj, një fokus i vazhdueshëm në operacione në terren do të godasë rrjetet kriminale që përfshijnë trafikun e drogës, armëve dhe njerëzve duke ulur ndjeshëm shkallën e krimit në territoret e prekura.

● **SPASTRIMI I POLICISË NGA ELEMENTË TË INKRIMINUAR**

Për të ripërtëritur integritetin e forcave të rendit, nevojitet një proces i thelluar hetimi dhe kontrolli të brendshëm, që të identifikojë dhe ndëshkojë çdo element të përfshirë në aktivitete të paligjshme ose korruptive.

Kjo përfshin auditime të rregullta, krijimin e një mekanizmi autonom për raportimin e abuzimeve dhe bashkëpunim me institucione të pavarura anti-korrupsion.

Një trupë policore e pastër jo vetëm që do të rrisë besimin e publikut në forcat e rendit, por do të mundësojë një reagim më të shpejtë dhe të efektshëm ndaj situatave emergjente, duke garantuar siguri të plotë për qytetarët.

● **REHABILITIM PËR TË RINJTË QË RREZIKOJNË TË PËRSHIHEN NË KRIM**

Parandalimi i krimit fillon në edukim dhe integrimin social. Krijimi i programeve rehabilituese dhe edukative për të rinjtë, që përfshijnë trajnime profesionale, mentorim, aktivitete sportive dhe kulturore, mund të jetë një alternativë efektive ndaj rrugës së krimit.

Këto programe jo vetëm që do të ndihmojnë në ndryshimin e perceptimeve dhe motiveve të të rinjve, por do të krijojnë edhe rrjete mbështetëse brenda komuniteteve, duke promovuar integrimin social dhe zhvillimin e aftësive që do të lehtësojnë përfshirjen e tyre në tregun e punës.

● **FORCIMI I PATRULLAVE NË ZONAT PROBLEMATIKE**

Për të siguruar një prani të vazhdueshme të forcave të rendit në zonat me nivele të larta kriminaliteti, është thelbësore rritja e numrit dhe mobilitetit të patrullave.

Kjo masë do të përmirësojë përgjigjen ndaj situatave emergjente dhe do të krijojë një prani të dukshme që shërben si parandalues për aktet kriminale.

Në të njëjtën kohë, ndërmarrja e fushatave të bashkëpunimit me komunitetin dhe organizatat vendore do të forcojë ndjenjën e sigurisë dhe besimit mes qytetarëve dhe forcave të policisë.



PUNËT E JASHTME

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

NJË POLITIKË E JASHTME AKTIVE DHE STRATEGJIKE ËSHTË THELBËSORE PËR TË GARANTUAR DINJITETIN DHE ZHVILLIMIN E SHQIPTARËVE BRENDË DHE JASHTË KUFIJVE. KËTO MASA KANË PËR QËLLIM TË RRISIN NDIKIMIN NDËRKOMBËTAR TË SHQIPËRISË DHE TË KRIJOJNË MARRËDHËNIE QË MBËSHTESIN INTERESAT KOMBËTARE

● **FORCIMI I DIPLOMACISË EKONOMIKE**

Një diplomaci ekonomike e fortë sjell një platformë për të tërhequr investime të huaja dhe për të promovuar produktet shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Përmes organizimit të misioneve diplomatike, pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare dhe nënshkrimit të marrëveshjeve strategjike, Shqipëria do të krijojë lidhje të reja ekonomike që do të stimulojnë rritjen e industrisë dhe krijimin e vendeve të punës.

Kjo politikë gjithashtu forcon imazhin e vendit si një partner i besueshëm dhe i hapur për bashkëpunime ekonomike ndërkombëtare.

● **PËRSHPEJTIMI I INTEGRIMIT EUROPIAN**

Zbatimi i reformave strukturore dhe krijimi i marrëdhënieve të forta me vendet anëtare të BE-së janë hapa kyç për integrimin europian të Shqipërisë. Ky proces jo vetëm që sjell avantazhe ekonomike dhe financiare, por gjithashtu rrit standardet demokratike dhe të drejtave të njeriut në vend.

Përmes këtij integrimi, Shqipëria do të përfitojë nga fondet strukturore europiane, do të përmirësojë infrastrukturën dhe do të krijojë një mjedis më të favorshëm për investime të huaja dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

● **ZHVILLIMI I NJË POLITIKE TË JASHTME AKTIVE PËR STABILITETIN RAJONAL**

Bashkëpunimi me vendet e Ballkanit për çështje strategjike si stabiliteti rajonal, zhvillimi ekonomik dhe lufta kundër aktiviteteve terroriste është i domosdoshëm. Një politikë e jashtme aktive do të nxisë dialogun dhe partneritetet e përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, duke sjellë një klimë të paqes dhe bashkëpunimit.

Kjo do të mundësojë bashkëpunime të reja në fusha të sigurisë, ekonomisë dhe politikës, duke forcuar kështu stabilitetin dhe ndikimin e rajonit.

● **MBROJTJA E TË DREJTAVE TË EMIGRANTËVE SHQIPTARË**

Për të siguruar që shqiptarët që jetojnë jashtë vendit të kenë mbrojtjen e duhur, duhet krijuar një sistem konsullor modern dhe efikas, në bazë të marrëveshjeve bilaterale.

Ky sistem do të ofrojë shërbime të përmirësuara, si asistencë juridike, mbështetje për përkthime dhe programe integrimi, duke u siguruar emigrantëve që të drejtat e tyre janë të garantuara dhe se ata kanë një lidhje të fortë me atdheun e tyre.

● **RRITJA E NDIKIMIT TË DIASPORËS NË POLITIKËN DHE EKONOMINË SHQIPTARE**

Diaspora shqiptare ka një potencial të jashtëzakonshëm për të kontribuar në zhvillimin e vendit përmes investimeve, trasmetimit të njohurive dhe ndikimit kulturor. Krijimi i mekanizmave që lehtësojnë investimet e diasporës dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse do të sjellë një burim të ri ideve inovative dhe do të forcojë lidhjet midis komuniteteve jashtë vendit dhe institucioneve tona në Shqipëri.

Kjo përfshirje e drejtpërdrejtë do të ndihmojë në formimin e një strategjie të përbashkët që mbështet zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë.

● **PLATFORMË E PËRBASHKËT E POLITIKËS SË JASHTME ME KOSOVËN**

Bashkëpunimi me Kosovën për çështjet që prekin interesat kombëtare, si njohja ndërkombëtare, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe përfaqësimi në forumet globale, do të rrisë peshën diplomatike të të dy vendeve. Një platformë e përbashkët sjell koherencë dhe një front të bashkuar për sfidat që kanë ndikim në rajon, duke rritur ndikimin dhe besueshmërinë në negociatat ndërkombëtare.

Kjo strategji do të shërbejë si një shembull i bashkëpunimit të ngushtë dhe do të kontribuojë në forcimin e stabilitetit dhe zhvillimit rajonal.



MBROJTJA DHE SIGURIA KOMBËTARE

PROGRAMI I PARTISË MUNDËSIA

NJË SHQIPËRI E FORTË DHE E AFTË TË MBROHET KËRKON INVESTIME STRATEGJIKE NË KAPACITETET USHTARAKE DHE NË BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR, NË MËNYRË QË TË PËRBALLOJË SFIDAT E NDRYSHME DHE TË FORCOJË MBROJTJEN E TERRITOREVE TË SAJ.

● **HARMONIZIMI I BUXHETIT TË MBROJTJES ME KËRKESËN ZYRTARE TË NATO-S**

Duke sinkronizuar buxhetin e mbrojtjes me standardet dhe kërkesat e NATO-s, Shqipëria do të ketë mundësinë të rrisë investimet në sektorin ushtarak në përputhje me normat ndërkombëtare. Kjo masë do të rezultojë në modernizimin e pajisjeve dhe trajnimeve, duke forcuar kapacitetet strategjike dhe duke rritur sigurinë kombëtare.

Në këtë mënyrë, vendi do të jetë më i përgatitur për sfidat e ardhshme, duke ofruar një mbrojtje të fortë dhe të qëndrueshme në territoret e tij, dhe duke forcuar rolin e Shqipërisë në aleancën europiane dhe atdhetare.

● **PAJISJA E USHTRISË ME TEKNOLOGJI MODERNE MBROJTËSE**

Investimi në teknologji të avancuara mbrojtëse është kyç për të garantuar se forcat e armatosura shqiptare janë të afta të përballojnë kërcënimet e ndryshme, qoftë ato kibernetike apo konvencionale. Përveç armatimeve moderne, trajnimi i personelit në përdorimin e sistemeve të reja do të rrisë efektivitetin dhe koherencën operacionale.

Teknologjia e avancuar do të mundësojë monitorim të vazhdueshëm, përgjigje të shpejtë dhe strategji të përditësuara për mbrojtje, duke bërë që ushtria të jetë gjithmonë në pararojë të inovacionit ushtarak.

● **RRITJA E PJESËMARRJES NË OPERACIONE NË KUADËR TË NATO-S DHE OKB-SË**

Angazhimi aktiv në misionet ndërkombëtare jo vetëm që kontribuon në paqen dhe stabilitetin global, por gjithashtu forcon imazhin e Shqipërisë si një partner i besueshëm në skenën ndërkombëtare. Pjesëmarrja në operacione të përbashkëta me aleatët e NATO-s dhe misionet e OKB-së rrit aftësinë e forcave shqiptare për të bashkëpunuar në terren, për të ndarë përvojë dhe për të përvetësuar praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Kjo përvojë ndërkombëtare do të kthehet në një forcim të kapaciteteve kombëtare.

- **FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME ALEATËT STRATEGJIKË, SIDOMOS SHBA-NË**

Bashkëpunimi i ngushtë me partnerë strategjikë, sidomos me SHBA-në, sjell avantazhe të shumta për avancimin e teknologjisë ushtarake dhe për përforcimin e lidhjeve diplomatike. Nëpërmjet shkëmbimit të njohurive, trajnimeve të përbashkëta dhe projekteve të inovacionit, Shqipëria do të përfitojë nga eksperiencia dhe resurset e vendeve më të zhvilluara.

Ky bashkëpunim ndihmon në krijimin e një rrjeti mbështetës ndërkombëtar, i cili kontribuon në sigurinë rajonale dhe në forcimin e marrëdhënieve strategjike me partnerët kryesorë.

- **MODERNIZIMI I BAZAVE USHTARAKE SHQIPTARE**

Për të siguruar një aftësi operationale të lartë, modernizimi i bazave ushtarake është thelbësor. Investimi në infrastrukturë moderne, përmirësimi i logjistikës dhe sigurimi i kapaciteteve të avancuara për trajnimin e forcave janë masa që rrisin aftësinë reale të ushtrisë.

Një bazë moderne ushtarake jo vetëm që rrit gatishmërinë për t'u përballur me çdo lloj kërcënimi, por gjithashtu shërben si një qendër për inovacionin dhe zhvillimin e strategjive të reja ushtarake, duke garantuar një mbrojtje të qëndrueshme dhe efektive për territoret shqiptare.



PËR NJË SHQIPËRI

KU IA DEL ME PUNË



KONTAKT WHATSAPP

 +355697052555

 MUNDËSIA.AL